

20180110123

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16), në nenin 29 paragrafi (3) pika 5) në alinenë 4 lidhëza “ose” shlyhet.

Në alinenë 5 pikëpresja zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Pas alinesë 5 shtohet aline e re 6, si vijon:

“- APTIS – së paku niveli B2 (B2)”.

Pika 6) shlyhet.

Neni 2

Në nenet 76-v, 76-g, 76-d paragrafi (4) shlyhet.

Neni 3

Në nenin 76-gj paragrafi (3) në alinenë 1 fjala “gjashtë” zëvendësohet me fjalën “tetë”.

Paragrafi (4) shlyhet.

Neni 4

Në nenin 76-e paragrafi (4) shlyhet.

Neni 5

Në nenin 77-gj paragrafi (3) fjalët: “një është nga radhët e artistëve të shquar nga Republika e Maqedonisë, ndërsa katër nga jashtë” zëvendësohen me fjalët: “nga radhët e artistëve të shquar, të nivelit, përkatësisht të nivelit më të lartë se niveli i kandidatit për të cilin udhëhiqet procedurë për punësim.”.

Neni 6

Në nenin 77-ll paragrafi (3) fjalët: “prej të cilëve një është nga radhët e artistëve të shquar nga Republika e Maqedonisë dhe katër nga jashtë” zëvendësohen me fjalët: “nga radhët e artistëve të shquar, të nivelit, përkatësisht të nivelit më të lartë se niveli i kandidatit për të cilin udhëhiqet procedurë për riaudicion.”.

Neni 7

Në nenin 82 paragrafi (2) në alinenë 5 numri “300” zëvendësohet me numrin “240”, ndërsa pas fjalës “drejtësisë” vihet presje dhe shtohet fjala “filozofisë”.

Alineja 8 ndryshohet si vijon:

“- posedon vërtetim për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe”.

Alineja 9 shlyhet.

Neni 8

Dispozitat nga neni 29 paragrafi (3) pika 5) të Ligjit për kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16) dhe dispozitat nga neni 1 i këtij ligji, me të cilat në nenin 29 paragrafi (3) në pikën 5 pas alinesë 5 shtohet aline e re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në 1 shtator 2018.

Neni 9

Drejtori i cili është emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në 1 shtator 2018, është i obliguar ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtorit i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afatin e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni i ndërpritet mandati.

Neni 10

Procedurat për punësim të artistit në institucionet nga sfera e kulturës dhe procedurat për riaudicion të artistëve të kategorisë A, të filluara nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të mbarojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.